

20240691515

**АГЕНЦИЈА ЗА СУПЕРВИЗИЈА НА КАПИТАЛНО ФИНАНСИРАНО ПЕНЗИСКО
ОСИГУРУВАЊЕ**

Sipas nenit 56, paragrafi (3), pika a) dhe paragrafi (4) të Ligjit të Sigurimit të Detyrueshëm Pensional të Financuar me Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018, 245/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 180/2019 dhe 103/2021) Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, në seancën e datës 28.9.2023, miratoi

V E N D I M
**PËR SHUMËN E KOMPENSIMIT MUJOR QË I PAGUHET AGJENCISË SË
MBIKËQYRJES TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL NGA
SHOQËRITË PENSIONALE PËR VITIN 2024**

Neni 1

Shuma e kompensimit mujor që i paguhet Agjencisë së Mbikëqyrjes të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional nga secila shoqëri pensionale, për vitin 2024, është 0.7% e totalit të kontributeve të paguara në muajin paraardhës në çdo fond pensional, me të cilin menaxhon shoqëria pensionale.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të publikohet pas marrjes së pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ky Vendim do të jetë në fuqi deri më 31. 12. 2024 dhe deri në marrjen e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për Vendimin për shumën e kompensimit mujor që i paguhet Agjencisë së Mbikëqyrjes të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional nga shoqëritë pensionale për viti 2025 dhe publikim e tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02-1391/3
5.10.2023
Shkup

Kryetari i Këshillit të
Ekspertëve,
Maksud Ali, d.v.